

ABSTRAKT

Rendi kushtetues dhe rregullimi juridik i një shoqërie mbetet gjithmonë një terren i përshtatshëm studimi për juristët e të gjitha akademive universitare e shkencore. Në kohën kur teoria e së drejtës edhe më tutje nuk arrin të definojë saktë se cili sistem kushtetues ofron më shumë liri dhe të drejta për individin dhe prosperitet e demokraci për shoqërinë, ky studim përqipet ta analizojë objektivisht mënyrën e funksionimit të Monarkisë shqiptare (1928-1939), si një nga sistemet politike përmes të cilave është qeverisur shteti shqiptar në gjysmën e parë të shekullit XX.

Në pjesën e parë të këtij hulumtimi trajtohen elementet e para të procesit të shtetndërtimit të shtetit shqiptar, duke paraqitur, krahasuar dhe analizuar karakteristikat themelore të këtij procesi shumë të vështirë: mungesën e sovranitetit të plotë shtetëror, mungesën e sistemit ligjor, imponimin e sistemit politik (monarkist) nga Gjashtë Fuqitë e Mëdha etj.

Më tej, në pjesën qendrore ky hulumtim merr karakter më shumë juridiko - konstitucional e më pak historik. Në këtë pjesë zberthehet (në diakroni) dhe analizohet (në sinkroni) sistemi politiko-juridik i Monarkisë shqiptare. Duke i paraqitur karakteristikat kryesore të kësaj monarkie që u proklamua në Tiranë më 1 shtator të vitit 1928, pastaj rrugën ligjore që ndoqi Asambleja Kushtetuese për ta ndryshuar sistemin politik nga ai republikan në atë monarkik etj., synohet të hidhet sado pak dritë mbi disa aspekte të panjohura, shpeshherë edhe të paragjykuara, të krijimit të Monarkisë shqiptare.

Pjesa qendrore e këtij hulumtimi, ndërkaq, analizon rrethanat dhe mënyrën e hartimit të aktit konstitucional të Mbretërisë shqiptare: Statutit Themeltar të Mbretërisë shqiptare. Me këtë rast jepen disa gjetje komparative (krahasuese) mes aktit kushtetues të Mbretërisë shqiptare me aktet kushtetuese të disa monarkive ballkanike dhe evropiane etj.

Po ashtu, në këtë pjesë të hulumtimit janë shtjelluar edhe aspektet kryesore të sistemit demokratik (zgjedhor) dhe të jetës parlamentare në kohën e Mbretërisë shqiptare; është analizuar struktura e brendshme dhe funksioni i institucioneve kryesore të shtetit, duke filluar nga institucioni i Mbretit, i Parlamentit, i Këshillit të Ministrave, i organeve të kontrollit shtetëror (Këshilli i Shtetit dhe Këshilli Kontrollues), i sistemit të drejtësisë, i administratës vendore etj.

Në fund, përmes konkluzioneve, jepet një sintezë gjithëpërfshirëse mbi vlerat fundamentale të konstitucionalizmit të shtetit monarkik shqiptar (1928-1939), të cilat, për shkak të paradigmave historiciste, edhe më tej vazhdojnë të jenë të paragjykuara.